

STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SOL INVICTUS 08” SHPK

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë:

Ortakët Themelues vendosen të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe miraton këtë statut (më poshtë referuar si “Statuti”)

PJESA I
EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, SELIA
OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA,

Neni 1
Emërtimi


Shoqëria emërtohet “SOL INVICTUS 08 ” Shpk (në vijim referuar edhe si "Shoqëria").


Neni 2
Forma ligjore

“SOL INVICTUS 08” Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (në vijim referuar si ""Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"), dhe në përputhje me këtë Statut.

Neni 3
Selia

- 3.1 Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, selia e Shoqërisë është në Elbasan, në adresën: Lagja Sul Papri, Rruga e re, P 30/6, ap 14, Elbasan, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.
- 3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë selinë në pikën 3.1, të hapë seli të tjera operative, degë apo zyra përfaqesimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

Armand Skupi


Roveno Comaj


Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj sa vijon:

4.1 Ofrimi i konsulences dhe asistences teknike per projektimin, mirembajtjen, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, dhe te çdo materiali tjetër ndihmes te sistemit dhe rrjetit elektrik. Tregtim i energjise nga burime te rinovueshme. Konsulence dhe cdo aktivitet qe lidhet me fushen e energjise. Import eksport mallra e pajisje te teknologjise ne fushen energjitikes etj, qe do te perdoren ne ndertimin, mirembajtjen, dhe menaxhimin e centralit me impjante fotovoltaike e forma te tiera te prodhimit te energjise nga burime te rinovueshme. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve te ndryshme elektrike, impianteve/paneleve fotovoltaike, elektronike, sistemeve/impianteve termike, sisteme per mire menaxhimin e energjise, sisteme ndriçimi, te telekomunikacionit si dhe impianteve te tjera te ngjashme te destinuar per objekte civile dhe industriale, per sektore të ndryshme.


Shitja me shumice dhe pakice brenda dhe jashte vendit te materialeve te ndryshme elektrike dhe pajisjeve te tyre te te gjitha llojeve te materialeve te tjera industriale, si impiante ndriçimi, impiante te energjise alternative, impiante te mbrojtjes nga ngarkesat atmosferike, impiante portash, barrierash dhe kontrollit te dedikuar, impiante kundra grabitjes, zjarrit, permbytjeve dhe gazrave,

4.2 Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Neni 5 Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhe kohore te pakufizuar.

Armand Skupi


Rovena Collej


PJESA II
KAPITALI, KUOTA, KONTRIBUTI NE KAPITAL DHE CERTIFIKATAT E KUOTAVE
TË KAPITALIT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT, E DREJTA E P
ARABLERJES
DHE KALIMI I KUOTAVE

Neni 6
Kapitali - Kuota

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën ALL 100 (njqind) lekë kontribut perbashket i te dy ortakeve. Perkatesisht : Z.Armand Skuqi : 51 leke dhe Znj.Rovena Canaj 49 leke.

6.2. Pjesemartja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhteme.

1. Ortaku themelues: **Armand Skuqi**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 51 %(pesedhejte e nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise
2. Ortaku themelues: **Rovena Canaj** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 49 % (dyzetenente perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise

6.3 Kuota është e transferueshme në cdo kohë dhe mund të transferohet në përputhje me kushtet e parashikimet e legjislacionit në fuqi.

6.4 Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuti e paluajtshme apo te drejta). Ortaket qe pengohen te ushtrojne te drejtat qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise kane te drejte te kerkojne gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te caktuar si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjetesh nga rasti i cenimit.


Neni 7
Ortaket e Shoqerise

7.1 Shoqëria zotërohet nga Ortaket:

- **Armand Skuqi**, shtetas shqiptar, lindur më Tirane, datelindja 10.08.1974, dhe banues në Tirane, mbajtës i ID nr. Personal H 40810223U **zotërues i 1 (një) kuote**, me vlere te pergjithshme qe perben 51 %(pesedhejte e nje perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.
- **Rovena Canaj**, shtetase shqiptare , lindur ne Elbasan, datelindja 08.06.1985, me ID nr personal I 5568106U, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme qe perben 49 %(dyzetenente perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise

7.2. Ortaket përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojne personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributet e Ortakeve përbëjne

Armand Skuqi


Rovena Canaj


kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Ortakët gëzojnë kuotat e tyre në Shoqëri në përpjesëtim me kontributin e tyre në kapital.

Neni 8

Kontributi në kapital dhe certifikatat e kuotave të kapitalit dhe Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

- 8.1 Kontributi në kapital i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).
- 8.2 Ortaku në nomentin e marrjes së pronësisë së kuotës së kapitalit, fiton të drejtën të marrë pa pagesë, një certifikatë për kuotën që zotëron.
- 8.3 Për kuotën në zotërim të përbashkët nga disa zotërues lëshohet një certifikatë e vetme me emrat e renditur të zotëruesve të përbashkët sipas nenit 72 paragrafi (2) i Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
- 8.4 Shoqëria mund të zmadhojë në çdo kohë kapitalin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 8.5 Në rastin e zmadhimit të kapitalit, Ortakët kanë të drejtën e përparësisë për regjistrimin e kuotave në proporcion me vlerën e kuotave të tyre të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë.
- 8.6 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve deri në minimumin e përcaktuar në Ligjin Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
- 8.7 Vendimi për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit prej administratorit ose personave të autorizuar prej tij.

Neni 9

Kalimi i kuotave dhe e drejta e parablerjes

- 9.1 Kuota e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej saj mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - a) kontributit në kapitalin e Shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.
- 9.2 Kuotat janë lirisht të transferueshme:
 - nga Ortaku i Vetëm te të tretë;
 - midis ortakëve;
 - midis ortakëve dhe bashkëshorteve dhe/ose në favor të fëmijëve; dhe/ose


Armand Skupi
GK


Rovena Collej
Buj

- midis ortakëve dhe shoqërive të lidhura të kontrolluara nga ortakët.
- 9.3 Për çdo mënyrë të transferimit të kuotave (duke përfshirë edhe transferimin pa kundërshpërblim) te persona të ndryshëm nga ata që janë përcaktuar në pikën 9.2 më sipër, për transferimin, ortakët ekzistues të Shoqërisë gëzojnë të drejtën e parablerjes mbi kuotat e projektuara për t'u transferuar, në përputhje me rregullat e cituara në dispozitat në vijim.
- 9.4 Ortaku, që ka për qëllim të shesë apo të transferojë pjesëmarrjen e tij, duhet të njoftojë me shkresë Administratorin në adresën e selisë së Shoqërisë. Njoftimi duhet të përmbajë të dhënat personale të transferuesit të kuotave dhe të përfituesit të tyre, numrin e kuotave që do të transferohen, kushtet e transferimit, duke përfshirë çmimin dhe mënyrën e pagesës. Administratori brenda 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit për transferimin, do të njoftojë ortakët e Shoqërisë në lidhje me transferimin në fjalë.
- 9.5 Ortakët, të cilëve iu drejtohet njoftimi si më sipër, duhet të ushtrojnë të drejtën e parablerjes mbi pjesëmarrjen së cilës i referohet njoftimi, duke i dërguar ortakut ofrues dhe Administratorit me shkresë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit, deklaratën e ushtrimit të së drejtës së parablerjes. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesëmarrjen e ofruar.
- 9.6 Në rast se ortakët e tjerë dhe ortaku transferues nuk bien dakord me çmimin e kuotës/ve të propozuar nga ky i fundit, apo me vlerën e tregut në rastin e transferimit të kuotave pa kundërshpërblim, ata do të caktojnë një ekspert për të përcaktuar çmimin sipas vlerës së tregut, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Pas njoftimit të çmimit të shitjes së kuotave të përcaktuar nga eksperti, ortakët brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh duhet të njoftojnë me shkresë Administratorin dhe ortakun transferues për interesimin e tyre të blejnë kuotat me çmimin e përcaktuar nga eksperti.
- 9.7 Nëse një ose disa nga ortakët që kanë të drejtën e parablerjes nuk deshirojnë apo nuk mund të ushtrojnë këtë të drejtë, e drejta e tyre e parablerjes u kalon automatikisht dhe në përpjesëtim ortakëve të tjerë. Nëse asnjë nga ortakët nuk ka për qëllim të blejë pjesëmarrjen e ofruar sipas mënyrave dhe kushteve të përshkruara këtu, ortaku transferues do të jetë i lirë t'ia transferojë të gjithë pjesëmarrjen blerësit të përcaktuar në njoftimin dërguar ortakëve të tjerë. Transferimi do të konsiderohet si i miratuar në heshtje nëse ortakut transferues nuk i paraqitet asnjë njoftim për ushtrimin e të drejtës së parablerjes brenda 30 (tridhjetë) ditësh, ose kur nuk është arritur asnjë marrëveshje brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të transferimit në fjalë nga ortaku transferues.

PJESA III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, THIRRJA PËRFAQËSIMI, KUORUMI DHE
VENDIMMARRJA

Neni 10
Asambleja e Përgjithshme

Armand Skupi


Roveno Collej


- 10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra në përputhje me ligjin e zbatueshëm dhe me këtë Statut, janë detyruese për të gjithë ortakët, përfshirë ata që nuk marrin pjesë në votim dhe ata që votojnë kundër këtyre vendimeve.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të Shoqërisë për çështjet e mëposhtme:
- a) Ndryshimet e Statutit;
 - b) Përcaktimin e politikave, strategjive dhe objektivave tregtare dhe sociale të Shoqërisë;
 - c) Emërimin e shkarkimin e Administratorit/eve;
 - d) Përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të Administratorit/eve;
 - e) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) Shpërndarjen e fitimeve;
 - h) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të audituesve ligjorë;
 - i) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - j) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave dhe rregullave të Shoqërisë nga Administratori përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - k) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - l) Miratimin e rregulloreve dhe procedurave për mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - m) Disponimin me pasuritë e paluajtshme të Shoqërisë;
 - n) Disponimin me asetet dhe të drejtat e Shoqërisë;
 - o) Marrjen ose dhënie kredie, huaje apo cdo lloj forme borxhi në emër të Shoqërisë, përveç kredive bankare të përfituara në funksion të aktivitetit tregtar të zakonshëm të Shoqërisë;
 - p) Vendosje pengu ose barre hipotekore mbi pasuritë e Shoqërisë;
 - q) Autorizimin dhe heqjen e të drejtës së personave të autorizuar për të kryer veprime pranë llogarive bankare të Shoqërisë, përveç Administratorit.
 - r) Nënshkrimin e marrëveshjeve tregtare ndërmjet Shoqërisë dhe një ortaku të Shoqërisë apo Administratorit sipas nenit 13 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare;
 - s) Autorizon nënshkrimin e kontratave afatgjata të cilat e angazhojnë kontraktualisht Shoqërinë për një afat kohor më të gjatë se 1 (një) vit;
 - t) Autorizon nënshkrimin e kontratave dhe marrëveshjeve me palët e treta për vlera që i janë kufizuar Administratorit në Statut apo sipas Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare;
 - u) Miraton kompetencat shtesë të Asamblesë së Përgjithshme;
 - v) Çështje të tjera të parashikuara nga Ligji në fuqi apo Statuti.
- 10.3 Asambleja e Ortakeve merr vendime me shumicë të kualifikuar apo me shumicë të thjeshtë në përputhje me parashikimet në nenet 86, 87 e vijues të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare si dhe në këtë Statut.

Neni 11

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Armand Skupi
[Signature]

Rovena Cangj [Signature]

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e pasqyrave financiare, si dhe kur kjo kërkohet me shkrim nga një ose disa ortakë që zotërojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- 11.2 Administratori e thërret Asamblenë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga paraqitja e kërkesës së ortakëve. Në rast se Administratori nuk e thërret Asamblenë e Përgjithshme, ortakëve u lind e drejta ta thërrasin vetë Asamblenë e Përgjithshme, duke përcaktuar rendin e dites, kohën dhe vendin e takimit që në çdo rast nuk do të jetë më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga paraqitja e kërkesës në përputhje me procedurat e përcaktuara në dispozitat në vijim.
- 11.3. Përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë Statut, Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:
- a) Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
 - b) Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pesë përqind) të asetëve të Shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të audituara.
- 11.4 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e Shoqërisë apo pranë një vendi tjetër brenda ose jashtë selisë apo adresave të regjistruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 11.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të një njoftimi me shkrim të dërguar me postë të regjistruar, ose faks, ose nëpërmjet postës elektronike që i drejtohet secilit prej ortakëve. Njoftimi duhet të tregojë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe duhet t'i dërgohet secilit ortak, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë. Gjithashtu, njoftimi duhet të përmbajë, edhe mënyrën e pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme të ortakëve dhe/ose mënyrën e vendimmarrjes. Njoftimi i mbledhjes mund të parashikojë edhe një datë të dytë për mbledhjen e asamblesë në rast se mbledhja e parë nuk zhvillohet sipas njoftimit.
- 11.6 Njoftimi i mbledhjes mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike (e-mail), dhe në këtë rast konsiderohet i marrë nga ortakët në datën dhe orën e shënuar të njoftimit të postës elektronike.
- 11.7 Njoftimi i mbledhjes i dërguar me faks, konsiderohet i marrë nga ortakët në datën dhe orën e shënuar në mesazhin e marrjes/dorëzimit të gjeneruar nga pajisja e faksit.
- 11.8 Asambleja e Përgjithshme kryesohet nga personi i emëruar nga shumica e ortakëve pjesëmarrës ("Kryetari i Mbledhjes"). Kryetari i Mbledhjes emëron sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes së Asamblesë. Sekretar i mbledhjes mund të jetë edhe njëri nga ortakët, administratori, një punonjës tjetër apo person i tretë i caktuar me dakordësinë e ortakëve.


Armand Skupi
gle


Rovena Collej

- 11.9 Ortakët mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë nëpërmjet mjeteve elektronike si telekonferenca, apo video-konferenca, etj. Përdorimi i mjeteve elektronike do të kryhet duke marrë të gjitha masat teknike të nevojshme për garantimin e identifikimit të ortakëve, si edhe sigurinë e këtyre mjeteve elektronike. Në veçanti është e nevojshme të sigurohet përmbushja e këtyre kushteve:
- a) Kryetari i Mbledhjes të ketë mundësinë të verifikojë dhe të identifikojë ortakët të cilët janë të pranishëm, të kontrollojë mbërevajtjen e mbledhjes, të numerojë dhe të shpallë rezultatin e votimit;
 - b) Sekretari dhe/ose mbajtësi i procesverbalit të ketë mundësinë për t'u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura në mbledhjen, objekt të procesverbalit;
 - c) Të mundësohet pjesëmarrja e të gjithë të pranishmëve për të diskutuar mbi rendin e ditës, në shqyrtimin, marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha dokumenteve të përdorura gjatë mbledhjes si dhe në procesin e votimit mbi rendin e ditës.
- 11.10 Mbledhja e Asamblese në kushtet e përmendura në këtë Statut, konsiderohet rregullisht e mbajtur në vendin ku është i pranishëm Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtësi i procesverbalit, i cili bën të mundur përgatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes. Gjithashtu, Kryetari i Mbledhjes do të verifikojë identitetin e çdo ortaku pjesëmarrës ose përfaqësuesve të tyre.
- 11.11 Vendimet e ortakëve të marra si dhe diskutimet e ortakëve duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes të hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Procesverbali do të nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Në procesverbal pasqyrohet pjesëmarrja e ortakëve të pranishëm dhe të përfaqësuar, ose ortakët që kanë votuar me shkrim. Nëse vendimet e marra nga ortakët duhet të depozitohen pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhëna nëpërmjet konsultimit me shkrim do të shërbejnë si dokumente që provojnë të dhënat që do të depozitohen në këtë regjister.

Neni 12 Përfaqësimi

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe të votojë sipas pjesëmarrjes që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 12.2 Ortakët mund të marrin pjesë personalisht apo nëpërmjet përfaqësimit në Asamblesë e Përgjithshme nga një ortak tjetër apo një person i tretë i autorizuar nëpërmjet autorizimit me shkrim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje, e cila përfshin edhe mbledhjet e radhës me të njëjtin rend dite, Në rastet kur ortaku lëshon prokurë noteriale për përfaqësimin e tij në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme për një periudhë të caktuar, ai mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi me prokurë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së prokurës në perputhje me tagrat e përcaktuara në aktin noterial të përfaqësimit.

Armand Skupi


Rovena Collej


12.3 Administratori nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në Asamblenë e Përgjithshme.

Neni 13 **Kuorumi dhe Vendimmarrja**

- 13.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Statut, Asambleja e Përgjithshme vendos në mënyrë të vlefshme kur në mbledhje marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit dhe vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 13.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se $\frac{3}{4}$ të kuotave janë të pranishëm. Vendimi për këto çështje merret me $\frac{3}{4}$ e votave si përqindje e pjesëmarrjes në kapital.
- 13.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme e ortakëve nuk mund të vendosë për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar me lart, ajo mbledhet përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë për të njëjtin rend dite.

PJESA IV **ADMINISTRATORI I SHOQËRISE**

Neni 14 **Administratori**

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona si administratorë të Shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.
- 14.2 Kufizimet në lidhje me emërimin e administratorëve parashikohen në nenin 95 paragrafi (2) të Ligjit Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin/ët në çdo kohë me shumicë të thjeshtë të votave pjesëmarrëse në votim nëse plotësohet kuorumi i vendosur në këtë statut.
- 14.4 Administratori i parë i vetëm i Shoqërisë do të jetë:
- **Zj. Tamara Besatari, shtetase shqiptare, lindur me Elbasan, datelindja 11.09.1986, me nr ID personal I 65911059G.**

Neni 15 **Kompetencat e Administratorit**

Armand Stajqi
[Signature]

Rovena Collej [Signature]

- 15.1 Veprimtaria tregtare e Shoqërisë menaxhohet nga Administratori, i cili mund t'i ushtrojë të gjitha kompetencat drejtuese të Shoqërisë, duke përfshirë por pa u kufizuar në si më poshtë vijon, me përjashtim të kompetencave që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara nga neni 81 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare:
- a) zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) sigurimin e përpuethshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
 - c) kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
 - d) mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabël dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
 - e) përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
 - f) kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
 - g) thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme kur e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
 - h) përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përmbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e Shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek Asambleja e Përgjithshme, së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve;"
 - i) të punesojë ose të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
 - j) kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligjin në fuqi si dhe në këtë Statut;
- 15.2 Është e drejta e administratorit/ve të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kompetencat e tyre, tek persona të tretë.


PJESA V
AUDITUESI LIGJOR, VITI USHTRIMOR DHE PASQYRAT FINANCIARE,
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË


Neni 16
Audituesi Ligjor

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i pasqyrave financiare dhe i të dhënave kontabël të Shoqërisë, do t'i besohet një ose më shumë Audituesve Ligjorë.

Neni 17
Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare

- 17.1 Viti ushtrimor i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.
- 17.2 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe i Audituesit Ligjor, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Ligjin Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Armand Skupi


Rovena Cengj


17.3 Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

Neni 18 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 18.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj.
- 18.2 Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ose më shumë likuidatorë, dhe përcaktojë tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 18.3 Me marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin, Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi.

PJESA VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19 Mosmarrëveshjet


Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 20 Dispozita e fundit


Ky Statut perpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, me vlerë të njejtë ligjore, në gjuhën shqipe.

ORTAKET

ARMAND SKUQI



ROVENA CANAJ



Tiranë, datë 16.02.2023